

VENDIM
Nr.343, datë 13.5.1996

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR VLERËSIMIN E PASURIVE TË PALUAJTSHME
TË BANKAVE TË NIVELIT TË DYTË ME KAPITAL TËRËSISHT SHTETËROR**

Në bazë të nenit 5 të ligjit nr.8083, datë 16.11.1995 "Për transformimin e bankave tregtare në shoqëri tregtare dhe lejimin e privatizimit të tyre", me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Të gjitha bankat e nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror, Banka Kombëtare Tregtare, Banka Tregtare Agrare dhe Banka e Kursimeve të fillojnë procedurat për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme, në bazë të kriterëve të udhëzimit të Këshillit të Ministrave "Për rivlerësimin e kontabilizimin e pasurive të paluajtshme të bankave të nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi